



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2551/10 prot

Datë 17.11.2023

V E N D I M
Nr. 1180/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.11.2023, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83340-10-11-2023, me objekt: “LOT 6 - Blerje Aparatura për shërbimin e sëmundjeve të brendshme në SUT”, me fond limit 6,547,733.34 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës
- Autoriteti Kontraktor:** Spitali Universitar i Traumes
Rr. “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Health & Light” SHPK NIPT L42231011L Rruga: “Themistokli Germenji”, Nd 11, H.4, Ap.4, Njësia Administrative nr. 2, 1010, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83340-10-11-2023, me objekt: “LOT 6 - Blerje Aparatura për shërbimin e sëmundjeve të brendshme në SUT”, me fond limit 6,547,733.34 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Në datën 19.10.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike është administruar ankesa me nr. A/2023/3508 ankimi elektronik protokolluar me nr.2551 prot., e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. II.4. Me anë të shkresës nr. 2790/1 prot., datë 26.10.2023, (të ardhur në sistemin e ankesave elektronike), protokolluar me tonën me nr. 2551/2 prot., datë 26.10.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Vendimin për ankesën nr. A/2023/3508, datë 19.10.2023” mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë.

II.5. Me anë të shkresës nr. 2791/1 prot., datë 26.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2551/3 prot., datë 30.10.2023, autoriteti kontraktor ka ridërguar pranë Komisionit të

Prokurimit Publik vendimin për ankesën nr. A/2023/3508 datë 19.10.2023 mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II.6. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes "Health & Light" SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

"[...] 1. Pretendimi Nr. 1 mbi specifikimin "Të ketë të paktën 8.000.000 kanale procesimi".

Gama e kanaleve të procesimit në pajisjet mjekësore me ultratinguj është një faktor kritik që ndikon në cilësinë e imazheve. Këto kanale përpunimi i referohen numrit të kanaleve të pavarura të marrjes dhe përpunimit të të dhenave të disponueshme në pajisje.

Cilësi e përmirësuar e imazhit: Një numër më i madh i kanaleve të përpunimit mundëson cilësi më të mirë të imazhit. Çdo kanal mund të përdoret për të kapur dhe përpunuar të dhëna nga një element i ndryshëm, duke rezultuar në një paraqitje më të detajuar dhe të saktë të indit të imazhit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në imazherinë diagnostike, ku detajet e sakta anatomike janë vendimtare për diagnozat e sakta.

Rezolucioni i përmirësuar: Më shumë kanale përpunimi i mundësojnë pajisjes të arrijë rezolucion më të lartë hapësinor. Rezolucioni hapësinor i referohet aftësisë për të dalluar detajet e imëta në objektin e imazhit. Të kesh më shumë kanale do të thotë që strukturat më të vogla dhe anomalitë delikatë mund të vizualizohen më qartë.

Depërtim më i mirë i imazheve brenda trupit: Një numër më i madh kanalesh mund të përmirësojë aftësinë e makinës për të depërtuar thellë në trup. Kjo është thelbësore gjatë imazhit të pacienteve mase trupore me të lartë ose kur ekzaminohen strukturat e vendosura thellë brenda trupit. Kanalet shtese ndihmojnë në zbutjen e humbjes së intensitetit të sinjalit pasi valët e ultrazërit udhëtojnë më thellë në trup. Një numër më i madh i kanaleve të përpunimit rrit saktësinë dhe përdorimin në disiplinën e ndryshme, duke e bërë atë të përshatshme për një gamë më të gjerë të skenarëve klinike.

Përpunimi paralel: Rritja e kanaleve të përpunimit mundëson përpunimin paralel të të dhënave. Kjo do të thotë që elementë të shumtë mund të përpunohen njëkohësisht, duke përshpejtuar marrjen e imazhit dhe duke reduktuar kohën e ekzaminimit. Kjo është veçanërisht e dobishme në situata urgjente ose kritike.

Një numër më i madh i kanaleve të përpunimit mund të ndihmojë në reduktimin e artefakteve në imazhet me ultratinguj. Nëse një kanal përjeton ndërhyrje ose zhurmë, informacioni nga kanalet e tjera mund ta kompensojë atë, duke çuar në imazhe më të sakta .

Për imazhet me ultratinguj tredimensionale (3D) dhe katerdimensionale (4D), një numër më i madh kanalesh përpunuese është thelbësor. Këto teknika kërkojnë marrjen e të dhënave nga kendveshtrime të shumta. Me shumë kanale ofrojnë të dhënat e nevojshme për 1-indertimin e sakte të këtyre imazheve vëllimore.

Si përmbledhje: Diapazoni i kanaleve të procesimit të jetë 7.000.000 - 8.000.000 kanale procesimi. Ky diapazon është me i perhapuri në pajisjet bashkëkohore duke garantuar cilësinë në modelit me të fundit të pajisjeve me ultratinguj, ku dhe kompani të tjera si p.sh. Philips me versionet version EPIQ ofron kanale digjitale duke filluar nga 7.000.000, "Offers up to 7,071,744 total digital channels".

Pretendimi i OE qëndron pjesërisht. Ky specifikim modifikohet si vijon: "Të ketë të pakten 7.000.000 kanale procesimi)".

Për sa me sipër, ankesa për këtë pikë do të merret parasysh pjesërisht.

2. Pretendimi Nr. 2 mbi specifikimin "Të ketë thellësi imazhi në varësi të sondave dhe preseteve nga 2cm deri me 55cm ":

Specifikimet teknike në përputhje me ligjin e Prokurimit Publik nuk përmbajnë asnjë markë specifike prodhimi. Specifikimet e vendosura janë përpiluar për të prokuruar një pajisje mjekësore gjithëpërfshirëse dhe cilësore.

KSHA gjykon se ndryshimi i thellësisë së imazhit nga 55cm në 40 cm nuk ka ndonjë impakt të madh klinik.

Pretendimi i OE qëndron. Ky specifikim modifikohet si vijon:

"Të ketë thellësi imazhi në varësi të sondave dhe preseteve nga 2cm deri në minimalisht 40cm"

Për sa me sipër, ankesa për këtë pikë do të merret parasysh

4. Pretendimi Nr. 4 mbi specifikimin "Të mundësojë minimum një "frame rate" prej jo më pak se 5.000 fps (Hz)":

Shkalla e lartë e Frame rate mundëson imazhe në kohë reale, e cila është thelbësore në shumë aplikacione klinike. Ekografia në kohë reale i lejon mjekët të vizualizojnë strukturat levizëse brenda trupit, si rrahja e zemrës rrjedha e gjakut ose lëvizjet e fetusit, pa vonesë të konsiderueshme. Kjo është kritike për marrjen e vendimeve të menjëhershme të diagnostifikimit dhe trajtimit.

Shkalla e lartë e Frame rate rezulton në imazhe më të detajuara, gjë që rrit saktësinë e diagnozave, lejon zbulimin e ndryshimeve delikate dhe të shpejta në sjelljen e indeve ose organeve. Në kardiologji, një shkallë e lartë Frame rate, është e rëndësishme për identifikimin e anomalive në funksionin e zemrës.

Shkalla e lartë e Frame rate kontribuon në cilësi më të mirë të imazhit, duke reduktuar artefaktet e lëvizjes dhe duke përmirësuar qartësinë e përgjithshme të imazheve.

Shkalla e lartë e Frame rate është thelbësore për vlerësimin e sistemit vaskular, zbulimin e bllokimeve ose stenozeve dhe monitorimin e rrjedhës së gjakut në kohë reale. Një shpejtësi më e lartë siguron imazh të sakte dhe të detajuar të rrjedhës.

Frame rate ka të bëjë me imazhet e gjeneruara për sekonda pra sa më e lartë të jetë kjo vlerë aq më i pastër është imazhi. Duke qenë se kemi kërkuar një pajisje ekografike me cilësi shumë të lartë preferojmë të ketë edhe një imazh të tillë.

Gjithsesi, për të hapur sa më shumë rangu do të pranojmë edhe pajisje ekografike duke filluar nga 2500 fps (Hz) të cilën pjesa më e madhe e kompanive e ka, ashtu si edhe pajisjet e firmes Philips të cilat kanë Max Frame Rate 2800 fps.

Pretendimi i OE qëndron pjesërisht. Ky specifikim modifikohet si vijon: "Të mundësojë minimum një "frame rate" prej jo më pak se 2500 fps (Hz)"

Për sa me sipër, ankesa për këtë pikë do të merret parasysh pjesërisht.

[...]Për sa argumentuar më sipër, si dhe në kuadër të frymës së transparencës të cilën legjislatori e synon nëpërmjet legjislacionit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore për zbatim të tij, KSHA në respektim të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit nr. 162/2020

datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Komisioni i Shqyrtimit të ankesave i ngarkuar nga titullari i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit:

VENDOSI:

Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK[...].

II.7 Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. Date 01.11.2023 Nr. 1111/2023 vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83340-10-11-2023, me objekt: “LOT 6 - Blerje Aparatura për shërbimin e sëmundjeve të brendshme në SUT”, me fond limit 6,547,733.34 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumes.*
 - 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
 - 3. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.11. Me anë të shkresës nr. 2790/1 prot., datë 26.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2551/3 prot., datë 30.10.2023, autoriteti kontraktor ka ridërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin për ankesën nr. A/2023/3508 datë 19.10.2023.

II.12. Në datën 02.11.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, dërgon shkresë me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit Prokurimit Publik” me nr. prot 2551/5 për operatorët ekonomikë ankimues “Health & Light” SHPK dhe Autoritetit Kontraktor.

II.13 Në datën 06.11.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, dërgon shkresë me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik” me nr. prot 2551/6, për operatorët ekonomikë ankimues “Health & Light” SHPK dhe Autoritetit Kontraktor.

II.14 Pranë Komisionit Prokurimit publik është depozituar shkresa e Autoritetit Kontraktor me nr. 2930, datë 06.11.2023, protokolluar me tonën 2551/7, datë 07.11.2023, në lidhje me Pjesëmarrjen në seance Dëgjimore.

II.15 Në datën 13.11.2023, ora 13:00, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK dhe të autoritetit kontraktor “Spitali Universitar i Traumës”.

Në prani të palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, për sqarim në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë nga operatori ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, për sa i përket specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, u zhvillua seanca dëgjimore audio me përmbajtje si vijon:

APARAT EKOGRAFIKE ME 2 SONDA (KARDIAKE, LIENARE)

(Të ketë të paktën 8.000.000) Kanale procesimi

KPP pyet Autoritetin kontraktor: Si janë specifikimet teknike të pajisjeve objekt prokurimi në përputhje me nenin 36 të LPP, pra në cilën prej metodave të parashikuar në LPP është

mbështetur AK për hartimin e specifikimeve teknike, ju e keni pranuar pjesërisht. Duke e ulur ne 70000 ndërkohë kërkesa e ankimesit është 4.5 milionë.

Përfaqësuesit e autoritetit kontraktor sqarojnë se: Po ne e kemi pranuar pjesërisht duke e çuar ne 7000000, Ksha ka bërë një verifikim dhe përveç Siemensit që OE citon, kanë gjetur variant pihlips, Jemi bazuar në kërkesat funksionale të Makinerisë.

Perfaqesuesi i operatorit ekonomik – Nuk pranoj vendosjen e AK.

KPP- Mund të na thoni sesi vendosja e specifikimit të 8000000 kanale procesimi dhe ulja deri në 700000 do të kufizonte konkurrencën?

OE-Per keto prodhues korean është e thjeshtë të nxjerrin kosto me të ulët për keto pajisje, megjithë keto numra sepse klinikisht nuk janë gjë, dhe ulja në 4.5 milion kanale procesimi, nuk do të prekte aspak benefitet klinike, dhe do të kryente punën me se miri.

KPP drejtuar AK- vendosja 4.5 do të cenonte funksionalitetin e pajisjes?

AK-S'jam specialist i punës, ve re që bie posht ajo që thotë nuk ekzistojnë pajisje cilësore, pasi Philipsi është cilësor... Ksha ka evindetur se përveç brandit që citon Ak ka evidentuar dhe markën Philips.

KPP-Ne testimin e tregut keni evidentuar se janë 2 ose më shumë prodhues?

(Duke qenë se nuk ishin ekspertët e fushës KPP sygjeron që AK të përgjigjet me shkrim brenda ditës së Merkurit në orarin zyrtar)

AK- Shton se është e vërtetë se në kemi një sistem të tillë me 7000000 kanale dhe është sistemi më i mirë që kemi dhe perseri nuk ofron 8000000 por 700000, por ka një qëllim pse ka kaq shumë pasi mund të pajiset me sonda X-Matrix 56000 elemente dhe për të përballuar, për të marrë imazhe nga keto sonda me gjithë keto elemente duhet një artitëkturë e pasur elektronike, janë shumë kanale që nuk do të perdoren kurrë, pasi sondat e kerkuara nuk janë të një teknologjie, x-matrix dhe nuk ka aq elemente.

(Te këtë të integruar monitor touchscreen me të paktën Madhësi ekrani prej 14 inch dhe me rezolucion minimum 1.920x1080)

KPP drejtuar AK- Ku jeni bazuar sipas nenit 36??

AK-Gjithmone në funksionalitetin e pajisjes, Ksha ka evidentuar disa prodhues me keto permasa, s'më duket specifikim kufizues.

KPP-Si do të cenonte vendosja e ekranit 12 inch funksionalitetin e pajisjes?

AK- Në cilësinë e shikimit të Ekranit.

Pyetje për AK- Si e kufizon konkurrencën kërkesa e 14 inch ?

OE- citon përgjigjen e AK dhe me pas citon se ky ekran 14 inch nuk është ekran që shfaq imazhe, është ekran panel i cili zgjedh modalitetet e punës Ekos, është një touch screen që zgjedh modalitetet e punës së Ekos, zgjedh opsionet, sondën që përdor aty, nuk ka përfitim klimik ndryshimi i tij.

Te mundësoje minimum një frame rate prej jo më pak se 5.000 fps (Hz)

AK- Ka pranuar pjesërisht.

KPP drejtuar AK- Jeni dakort me modifikimin e AK?

OE- I njëjti qëndrim logjik si në pikën e 1, specifikimin e 1 në këto seanca, është me shumë sec duhet, është për një sistem shumë më të avancuar dhe për ato sonda që AK nuk i kërkon, është thjesht copy paste 5000. E ftojme të ndryshojë këto specifikime

Te këtë mundësi vendosje bateri litiumi ose ekuivalente për mundësimin e transportimit të Ekos pa shpëputje me minimumi një bateri prej 6.500 mah, dhe minimum kohë skanimit jo më pak se 40 minuta.

KPP drejtuar AK- Ku jeni bazuar në vendosjen e specifikimit?

AK- Gjithmone ne funksionalitetin e pajises, besoj se mjeket kane nevoje ne levizjen, pra duhet të jene portabel, gjithsesi eshte pjese e vecante, nuk eshte pjesë e pajisjes, është ekstra. Por KSHA ka vendosur qe mund te jetë dhe me një UPS te jashtem, për pajisen nuk ngushton konkurrencen. Nese nuk e plotesoni kete specifikim ne kthim – përgjigje, ka pranuar se mund te behet dhe me UPS te jashtem, ne menyre qe te kete mundesi te levize pajisja dhe te mbaje deri ne 40 min.

KPP drejtuar OE- Komenti ankimesit lidhur me specifikimin e vendosur nga AK , cfare kerkoni dhe si kerkoni te ndryshohet ky specifikim?

OE- Te hiqet kapaciteti i baterisë, pasi nga prodhues te ndryshem eshte i ndryshem, te vendoset koha minimale qe 30 min, eshte kohe e mjaftueshme, po flasim per nje spital traume, i cili nuk eshte spital fushor dhe ka nderprerje energjie, modalitetin e siguron dhe 30 min kjo do te ishte e mftuehme, dhe per pajisjen e levizhsme.

KPP per AK- Vendosja e kohes per 30 min dhe bateria e litiumit me vlere me te vogel do ta cenonte funksionalitetin e pajisjes ?

AK- 30 min eshte minimumi

KPP- A do arrinin doktoret te benin proceset e punes me kete lloj?

AK- Eshte koha e transportit dhe koha e ekzaminimit, nga nje lokacion ne nje lokacion, ajo e baterise mund te ndryshoje, pasi kapaciteti i baterise nuk ndikon, s'ka rendesi per ne, rendesi ka te ruaje kohe sa me te gjate. Por sa me e gjate te jete koha aq me shume duhet bateria.

(Brenda dites se merkure nga KPP i lihet detyre AK te argumentoje ne menyre shteruese).

Sonde lineare për vazat (1 cope): Minimumi i frekuencës: 2 ~ 14 MHz (banda e frekuencës)

KPP drejtuar AK- Ku jeni bazuar ne vendosjen e ketij specifikimi parashikuar nga neni 36 i LPP?

AK- Nevoja te funksionalitetit, kerkesa e OE eshte me e vogel nga ajo qe kemi vendosur ne.

KPP- Atehere sipas jush kerkesa nga ana e ankimmuesit eshte me kufizuese nga ajo qe eshte kerkuar nga AK.

KPP- Komenti i Ankimesit lidhur me kete kerkese?

AK- PO flasim per nje sonde lineare. Perdoret per marrjen e imazhit te vazave siperfaqesore, imazhin e tiroideve siperfaqesre dhe cdo anatomi siperfaqesore, principi i ultrasonografise, eshte i tille, sa me e madhe frekuenca aq me i madh eshte penetrimi, sa me e vogel frekuenca aq me i thelle eshte penetrimi.

Për nje sonde lineare si 2 MHz; 3 Mhz ; 4 Mhz eshte e panevojshme. Nuk ka kufizim klinik.

Monitori i aparatit te jete minimum 23 inch LCD ose LED dhe me rezolucion minimum 1.020x1080

KP drejtuar AK- Ku jeni bazuar ne vendosjen e ketij specifikimi teknik?

AK- Ne funksionalitetin e Pajisjes besoj se 23 inch eshte me kollaj per ta perdorur.

KPP drejtuar AK- Ulja ne 21.5 Inch do ta cenonte funksionalitetin e pajisjes?

AK- Po shikoj, se KSHA kane gjetur dhe 3-4 kompani te tjera, qe e kane mbi 23, dmth nuk eshte kufizuese, mund te jete tregues i nje pajisjeje jocilesore ulja e permasave.

KPP- Nga ana vizuale, ai qe do perdore kete pajisje, mund ta perdore kete aparature me 21.5 inch?

AK- Mesa shikojme KSHA, ka gjetur disa prodhues me ekran 23 inch.

KPP drejtuar OE- Komenti i ankimesit lidhur me uljen e inch?

AK- Me saktesisht është 3.7 ose 3.8 cm ne diagonal, nga ana vizuale nuk perben asnje problem per Ak, per ate qe perdor pajisjen dhe pse te mos kerkojme nje funksionalitet qe

doktori me ane te nje butoni te maksimizonte te gjithë ekranin ne pamjen e imazhit klinik qe do te shohe.

II.15 Në datën 16.11.2023, në forme komunikimi elektronik nëpërmjet e-Mail është protokolluar shkresa e Autoritetit Kontraktor me nr. 2551/8 datë 16.11.2023.

II.16 Pranë Komisionit Prokurimit publik është depozituar shkresa e Autoritetit Kontraktor me nr. 3037, datë 15.11.2023, protokolluar me tonën 2551/9 datë 17.11.2023, më lëndë “Informacion plotësues për ankesën A/2020/3508 datë 19-10-2023”

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK dhe i cili në mënyre të përmbledhur argumenton se:[...] “

Kërkohet : Te ketë te paktën 8.000.000 kanale procesimi Sqarim : NË faqen 25 të katalogut gjendet kjo vlerë . Ky numër kanalesh është i panumërueshëm dhe është tipik për produkte aziatike vetëm për efekte komerciale. Kërkesë : kërkojmë që numri i kanaleve të bëhet min 4.5 milionë kanale procesimi

Argumenti 3 kërkohet : Te ketë te integruar monitor touchscreen me te paktën madhësi ekrani prej 14 inch dhe me rezolucion minimum 1.920x1080 Gjetje : Në faqen 5 të katalogut gjendet kjo vlerë. Kërkesë : kërkojmë që ky specifikim të bëhet në min 12inch sepse askush tjetër nuk e ka 14 inch dhe për më tepër që nuk sjell asgjë në aspektin klinik.

Argumenti 4 kërkohet : Te mundësoje minimum një frame rate prej jo me pak se 5.000 fps (Hz) Gjetje : Ne faqen 6 të katalogut gjendet kjo vlerë. Kërkesë : kërkojmë që kjo vlerë të bëhet 1900 fps sepse është më se e mjaftueshme si për ekzaminimet kardiake ashtu dhe për ekzaminimet e imazherisë së përgjithshme

Argumenti 5 kërkohet : Te ketë mundësi vendosje bateri litiumi ose ekuivalente për mundësimin e transportimit te ekos pa shkëputje me minimumi një bateri prej 6.500 mah, dhe minimum kohe skanimi jo me pak se 40 minuta. Gjetje : NË faqen 4 të katalogut gjendet kjo vlerë. Kërkesë : kompanitë kanë zgjidhjet e tyre optimale sa i takon sigurimit të vazhdueshmërisë së procesit të ekzaminimit në rast të shkeputjess së energjisë elektrike. Detajimi i tepërt i këtyre kërkesave thjesht sjell eliminimin e plotë të konkurrencës.

Argumenti 6 kërkohet : Sonde lineare për vazat (1 cope): Minimumi I frekuencës: 2 ~ 14 mhz (banda e frekuencës) Sqarim : Shihni faqen 38 të katalogut kërkesë : përcaktimi i frekuencave fjalë për fjalë sipas katalogut është thellësisht absurd. Kërkojmë që ky specifikim të bëhet min 5-12 mhz

Argumenti 7 kërkohet : Monitori I aparatit te jete minimum 23 inch LCD ose LED dhe me rezolucion minimum 1.020x1080 Sqarim : Shihni faqen 4 të katalogut kërkesë : Standardi në

mbarë botën është 21.5 dhe 23 inch nuk sjell asnjë diferencë kërkesë : kërkojmë që të ndryshohet në min 21.5 inch [...], **Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,**

III.1.1. Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike në lidhje me pajisjet objekt - prokurimi :

Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Aparat Ekografie me 2 (dy) sonda (Kardiake, lineare)

Te mundësojë metodat e imazhit:

- 2D Mode, M Mode, Color Doppler, Poëer Doppler, Pulse Èave Doppler, CÈ, TDI Mode, TDÈ Mode,
- Te mundësoje opsionet e kombinuara duplex dhe triplex ne real time. Te mundesoje Singel Mode, dual, quad, simultaneous (triplex), zoom mode (read/ërite), zmadhim te pamjes se skanimit ne ëide ose large screen.
- Te ketë mundësi përdorimi ne fushat e kardiologjisë sikurse dhe ne radiologji dhe gjinekologji si opsione standarte me presetet e kaluara ne aparature dhe matjet përkatëse për radiologji, kardiologji dhe obsetri, gjinekologji.
- Të punoje me tension 110V/220V, 50/60Hz (nese 110 te kete adaptor)
- Te ketë minimumi 4 porta aktive.
- Te shoqërohet me printer Bardh e Zi termik.
- Te ketë te paktën 8.000.000 kanale procesimi**
- Frenkuenca e aparatit te jete nga 1 deri me 18MHz
- Te ketë thellësi imazhi ne varësi te sondave deh preseteteve nga 2cm deri me 55cm
- Te ketë minimum 8 pika fokusi te selektueshme
- Te mundësoje minimum një “ frame rate” prej jo me pak se 5.000 fps (Hz)**
- Te mundësoje post-procesim te imazhit ne modes: B-Mode, M-Mode, PÈ/CÈ, Color Doppler, 3D, dhe Elastostografi.
- Te ketë SSD Disk me minimum 512Gb me RAM te paktën 16gb DDR4
- Te jete i pajisur me te paktën 2 dalje HDMI dhe 4 porta USB 2.0 ose version 3.0

- Te kete mundesi vendosje bateri litiumi ose ekuivalente për mundësimin e transportimit te ekos pa shkëputje me minimumi një bateri prej 6.500 mAh, dhe minimum kohe skanimi jo me pak se 40 minuta.
- Te kete Raporte te editueshme ku mund te perfshihen imazhet dhe komentet e mjekut per printim ne leter A4.
- Te kete te perfshira matjet dhe presetet per kardiak, abdominal, muskoseletal, gjinekologjik/obstetrical etj.
- Monitori I aparatit te jete minimum 23 inch LCD ose LED dhe me rezolucion minimum 1.020x1080**
- Te vije i pajisur me DICOM.
- Te ketë te paktën 6 mbajtëse sondash, deh mundësi kthimi te consoles minimum prej +-30o.
- Te jete i pajisur me tastiere numerike ne ekran prekës (touch screen) sikurse dhe ne konsolle te aparatit.
- Te ketë te integruar monitor touch screen me te paktën Madhësi ekrani prej 14 inch dhe me rezolucion minimum 1.920x1080.**
- Te ketë mundësi opsiioni instalimi per te ardhmen te opsioneve AutoEF, Elastografi per gjirin dhe tiroiden, Elastografi Shareëve, 3D/4D, Skanim Panoramic, Matje automatike te IMT, Guide per Biopsi, EKG, stress eko, Strain.
- Te mundësoje matje automatike.
- Te jete i pajisur me opsjon te tranferimit te imazheve ëireless ne aparatet celulare te mjekut dhe pacienteve nëpërmjet rrjetit Ëi-Fi ose nëpërmjet barcodeve (IOS dhe Android)
- Te ketë te përfshire e opsiomit te shtimit dhe mundësinë e instalimit ne te ardhmen te sondes TEE me frekuence 3 deri ne 7Mhz.
- Prodhim i vitit te fundit 2022-2023

Sonde Kardiake (1 cope)

- Band Ëidth : thelesia minimum nga 1 ~ 5 MHz (banda e frekuences)
- Field of vieë: minimum 90 ° (kendi I pamjes se imazhit)
- Minimumi ielementeve te sondes 80 (numri I elementeve)
- Biopsy Guide: te kete mundesi te marre biopsy (biopsia guida)
- Aplikimet : Abdomen, Cardiac, Vascular, TCD, Pediatric, Emergency (abdomen, vaskulare, kardiake, TCD, pediatrike dhe urgjence).

Sonde lineare per vazat (1 cope):

- Minimumi I frekuences: 2 ~ 14 MHz (banda e frekuences)**
- Minimumi I gjatesise se sondes se skanimit 50mm (gjatesia e e sondes)
- Minimumi (numri i elementeve te sondes) 256 kristale
- Opsjon per (biopsia guida e disponueshme)
- Aplikime : Abdomen, MSK, Small Parts, Vascular, Obstetrics, Gynecology, Pediatric

INTERFACE I PERDORUESIT

- Anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, italisht, portugalisht etj
- Pesha jo me shume se 85kg
- Sistem operativ me te pakten Ëindoës 10 ose 11 ose Linux.

Garancia: Jo më pak se 1 (Një) Vit.

Sasia: 1 Copë (duke përfshire dhe aksesoret e sipër përmendur)

III.1.2 Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.3 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Gjithashtu, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit.. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrin të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen

drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”* Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”* Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrajnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafshuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”,*

e ndryshuar". Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkëlqje e pretenduar". Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës *se ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.1.4. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.5. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: "*Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit*",

Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni i Prokurimit Publik, organizoi një seancë dëgjimore midis përfaqësuesve të operatorit ekonomik ankimues, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor pjesë e njësisë së prokurimit që është marrë me hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike të procedurës objekt-shqyrtimi. Gjatë seancës, në pyetjet drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni gjykoj të nevojshëm sqarimin si mbi metodën e ndërtimit të specifikimeve teknike, por edhe në drejtim të rolit në funksionalitetin e pajisjes të secilës prej specifikimeve teknike të cilat pretendohen nga ankuesi se janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik, si dhe a i shërben funksionalitetit dhe qëllimit të pajisjes hartimi në mënyrë kaq të detajuar i specifikimeve teknike. Gjithashtu, për ankuesin u drejtuan pyetje në drejtim të provueshmërisë së faktit, se përse specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe se si këto të fundit mund të ndikojnë në kufizimin e konkurrencës.

III.1.5. Lidhur me pretendimet e ankimuesit në lidhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor për pajisjen 1. Aparat Ekografie me 2 (dy) sonda (Kardiake, lineare) me specifikime **Te ketë te paktën 8.000.000 kanale procesimi; Te mundësoje**

minimum një “ frame rate” prej jo me pak se 5.000 fps (Hz) ; Monitori I aparatit te jete minimum 23 inch LCD ose LED dhe me rezolucion minimum 1.020x1080 ; Minimumi I frekuences: 2 ~ 14 MHz (banda e frekuences; Te ketë te integruar monitor touch screen me te paktën Madhësi ekrani prej 14 inch dhe me rezolucion minimum 1.920x1080, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret/specifikime që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifitime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifitime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifitime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorët të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

KPP gjykon, se sa më sipër arsyetuar, në lidhje me mënyrën e hartimit të specifitimeve teknike, rritet shprehësisht se autoritetet kontraktore në hartimin e specifitimeve teknike, krahas përshkrimit të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifitimeve teknike duhet të bëhet në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, si dhe të mos shërbejnë si pengesa për pjesëmarrjen e të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor, në lidhje me kërkesat e mësipërme Te ketë te paktën 8.000.000 kanale procesimi; Te mundësoje minimum një “ frame rate” prej jo me pak se 5.000 fps (Hz) ; Monitori I aparatit te jete minimum 23 inch LCD ose LED dhe me rezolucion minimum 1.020x1080 ; Minimumi I frekuences: 2 ~ 14 MHz (banda e frekuences; Te ketë te integruar monitor touch screen me te paktën Madhësi ekrani prej 14 inch dhe me rezolucion minimum 1.920x1080 , ka kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të cilët mund të ofrojnë produkte me një specifitime të tjera, prandaj kërkesa e operatorëve ekonomikë “Health & Light” SHPK dhe “Bnt Electornics” SHPK për rishikimin e specifitimeve, por pa ndikuar në cilësinë dhe funksionalitetin e tij, është një kërkesë e drejtë, e cila i shërben hapjes së konkurrencës, si dhe qëllimit dhe objektit të kësaj procedurë prokurimi.

Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, gjatë seancës dëgjimore, nuk ka argumentuar apo provuar as ligjërisht, as teknikisht, se specififikimet e hartuara prej tij nuk e kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe pse këto specifitime teknike nuk i drejtojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës vetëm drejt një prodhuesi dhe se ndryshimi i tyre ndikon në funksionalitetin e pajisjes dhe në qëllimin e përdorimit të saj. Akoma më tej, një ndër pyetjet e Komisionit të Prokurimit Publik, ishte nëse kishin kryer testim tregu, gjë e cila iu la për detyrë AK për kthim - përgjigje në formë shkresore. Në këto kushte, me qëllim hapjen e diapazonit të zgjidhjeve të propozuara, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë specififikimet teknike të mësipërme, duke i hartuar ato bazuar në funksionalitetin që kërkohet, pa përcaktuar parametra fikse, por duke pasur parasysh se këto specifitime nuk duhet të cenojnë funksionalitetin e pajisjes.

Sa më sipër, pretendimet e ankimesit qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për ndryshimin e specifikimit “*këtë mundësi vendosje bateri litiumi ose ekuivalente për mundësimin e transportimit të ekos pa shkëputje me minimumi një bateri prej 6.500 mAh, dhe minimum kohe skanimi jo më pak se 40 minuta*”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, ka përgjegjësi të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe kthim - përgjigjes së autoritetit kontraktor, ku ka pranuar dhe mundësinë e një UPS, dhe parashtrimeve në seancën dëgjimore nga ana e AK lidhur me këtë pretendim, e ka argumentuar në mënyrë shteruese, pse ky specifikim teknik në ndryshimin e tij, do të ndikonte në funksionimin e mirë të procesit të punës, dhe se kjo bateri duhet të ketë një minimum kohejo më pak se 40 minuta”, por nga ana tjetër lidhur me kërkesën për *bateri litiumi ose ekuivalente për mundësimin e transportimit të ekos pa shkëputje me minimumi një bateri prej 6.500 mah*, Komisioni Gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të përcaktojë specifikime fikse për sa i përket kapacitetit të baterisë por të modifikojë këtë specifikim duke lejuar ofromin edhe të produkteve të tjera (Bateri) të cilat nuk ndikojnë në funksionalitetin e kësaj aparature, dhe realizojnë qëllimin e Autoritetit Kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht .

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83340-10-11-2023, me objekt: “LOT 6 - Blerje Aparatura për shërbimin e sëmundjeve të brendshme në SUT”, me fond limit 6,547,733.34 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

